



SIKA AT WORK

RESTAURIMI I NJË NDËRTESE PRIVATE, MAMINAS

Sistem Ilaçi të përforcuar me tekstil (TRM): Sika Monotop®, SikaWrap®
Sistem për termoizolim të jashtëm (ETICS): Sika ThermoCoat®

BUILDING TRUST



RESTAURIMI I NJË NDËRTESE PRIVATE, MAMINAS



PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Më 26 nëntor 2019 në orën 03:54 CET, Shqipëria veri-përqendrore u trondit nga një tërmet i fortë me magnitudë 6.4 me epiqendër 16 kilometra perëndim-jugperëndim të Mamurrasit. Tërmeti zgjati për të paktën 50 sekonda dhe u ndje gjithashtu edhe në kryeqytetin e Tiranës.

Shumë ndërtesa u shkatërruan në qytetin e portit të Durrësit dhe në fshatin e Kodër-Thumanës. Dëmtime të rënda të ndërtesave ishin gjithashtu të pranishme në qytetet e Tiranës, Laçit dhe Lezhës të cilat ndodhen afër epiqendrës së tërmetit.


Njëra nga këto, ishte dhe kjo ndërtesë private që ndodhet në Maminas (10 km nga epiqendra e tërmetit), e cila kishte dëmtime në një pjesë të madhe të mureve, fasadës, mureve lidhës me kolona betoni. Plasaritje diagonale u përhapën nëpërmjet llaçit dhe tullave që solën si pasojë dështimin e muraturës.

Të gjitha punimet e restaurimit dhe termoizolimit të jashtëm u kryen gjatë dhjetorit 2019 – janarit 2020.

KËRKESAT E PROJEKTIT

Ndërtesa ishte tashme në përdorim nga një familje dhe nga disa biznese të vogla të zonës, por pas tërmetit banimi në të nuk ishte më i sigurtë. Kështu që, të gjitha ndërhyrjet e nevojshme në strukturë duhej të përfundonin sa më shpejtë për të shmangur aksidentet e mundshme.

Për të bërë këtë gjë të mundur, kontraktori kërkoi përdorimin e sistemit TRM (Textile Reinforcement System, sistemi i llaçit të përforcuar me tekstil) për riparim antisizmik, riparimin e mureve të brendshëm, riparimin e plasaritjeve mbi fasadë dhe ringritjen e mureve të rrëzuar. Gjithashtu i nevojshëm ishte dhe restaurimi i kolonave të dëmtuara prej betoni dhe aplikimi i sistemit ETICS për termoizolimin e jashtëm për një ndërtesë me efikasitet energjetik.






ZGJIDHJET NGA SIKA

a) TRM & ankorim

Zgjidhja nga Sika për projektin ofron një gamë të plotë materialesh riparuese. **Sika MonoTop®-627 HP** u përdor si një llaç me performance të lartë gati për përdorim me 1 përbërës për riparime të shpejta betoni të shkallës R4 mbi kolonat prej betoni.

Përforcimi kundër termetit të mureve përfshinte integrimin e një sistemi përforcues me tekstil, që përbëhej nga **Sika MonoTop®-722 Mur E**, një llaç me bazë çimentoje dhe i përforcuar me fibra gati për përdorim në kombinim me **SikaWrap®-350G Grid**, një rrjetë me fibra qelqi e pajisur me një veshje rezistente ndaj alkaleve.

Ngjitësi për ankorim me tharje të shpejtë **Sika AnchorFix®- 2+** u përdor për ankorimin e shufrave prej çeliku për të lidhur muret ekzistues me të rinjtë.





b) ETICS - Sistemi për termoizolim e jashtëm të fasadave

Për fasadën e ndërtesës u përzgjedh zgjidhja me systemin e termoizolimit të jashtëm. Kushtet klimatike me dimër shumë të ftohtë dhe me lagështi, era e fortë nga bredgeti dhe vera e nxehtë kërkojnë aplikimin e një sistemi i cili ofron kursim të lartë energjetik, optimizim të ngrohjes/ftohjes, si dhe një sistem të qëndrueshëm për vetë fasadën.

U propozua dhe u aplikua mbi fasadë sistemi **Sika ThermoCoat® ETICS**, i cili përbëhet nga:

- **Sika® ThermoCoat-1/3 HS:** Ilaç me bazë çimentoje 1K për ngjitje dhe suvatim me rrjetë (certifikuar sipas EN 998-1).
- **Sika® ThermoCoat-2 HS:** I bardhë ose gri (përmban grafit) EPS 60-200 në trashësi të ndryshme (certifikuar sipas EN 13163).
- **Sika® ThermoCoat-4 HS:** Rrjetë fibrash qelqi me rezistencë ndaj alkeleve.
- **Sika® ThermoCoat-5 HS Primer:** Prajmer me bazë uji përpara veshjes me grafiato.
- **Sika® ThermoCoat-5 HS Silic:** Veshje finirimi në formë paste dhe me bazë silikoni (certifikuar sipas EN 15824)
- **Certifikimi i sistemit:** ETA no 11/0358, sipas ETAG 004



U kërkua gjithashtu rifreskimi dhe dekorimi i disa pjesëve të fasadës. Sika furnizoi projektin me sasi të nevojshme të **SikaColor®-650W**, një bojë elastike, transpiruese, e padepërtueshme nga uji dhe me 1 përbërës të cilat është e tretshme në ujë dhe ka bazë akrilike dhe është krijuar posaçërisht për mbrojtjen dhe dekorimin e fasadave.



SASIA E PRODUKTEVE SIKA QË U PËRDORËN:

Sistem i përforcuar me tekstil (TRM):

Sika MonoTop®-722 Mur: **2 ton**

SikaWrap®-350 Grid: **150 m²**

Sistemi për termoizolim të jashtëm (ETICS):

Sika ThermoCoat®-5 HS Primer: **125 kg**

Sika ThermoCoat®-1/3 HS Primer: **1,2 ton**

Sika ThermoCoat®-4 HS Yellow: **330 m²**

Sika ThermoCoat®-5 HS Silic: **725 kg**

SikaColor-650W: **100 L**

Llaç riparues:

SikaRep®-200 Multi: **100 kg**

Ankorim:

Sika® AnchorFix-2+: **12 copë**



Sika Albania SHPK
Rinas Road, Tirana Business Park
Building No 7, 4th floor,
Tiranë, Albania

Contact
Tel.: +355 4 454 0070
alb.sika.com / info@al.sika.com

PJESËMARRËSIT NË PROJEKT:

Pronësia: Bujar Kareci

Aplikues-kontraktor: Edmond Perolli

BUILDING TRUST

